

Mbi
Auditimin e Brendshëm
Ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Ndjekjes Investimeve të
Infrastruktures,Sektori i Planifikimit e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës- Bashkia Shkodër

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar ne ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik”, zhvilloi një mision auditimi financiar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Ndjekjes Investimeve te Infrastruktures,Sektori i Planifikimit e Mirëmbajtjes se Infrastruktures- Bashkia Shkodër, per periudhen 01 Korrik 2014 – 31 Maj 2018 nga auditimi rezultoi:

III. Permbledhje ekzekutive

Drejtoria e Shërbimeve Publike Ndjekjes Investimeve të Infrastrukturës,Sektori i Planifikimit e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës - Bashkia Shkodër.Gjate auditimit jane konstatuar mangësi në kontratën themelore ku nuk janë përfshire si pjesë integrale rrugët në të cilat do të ndërhyhet me preventive analitikë si dhe afat te kryerjes se punimeve.Ne aneksin kushte te veçanta te kontratës nuk janë përcaktuar specifikimet teknike të kryerjes së punimeve.Kërkesa për shpenzime është paraqitur në total,pa u shoqëruar me analizë të shpenzimeve sipas vendndodhjes së rrugëve dhe trotuareve si dhe pa planimetri te ndërhyrjes, gjithashtu nuk është bërë miratim nga autoriteti kontraktor në fillim te vitit buxhetor.Për vitet 2017 dhe 2018 jane ndryshuar preventivat fitues, te cilat nuk duhet të ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese. Mbikeqyrja e punimeve nuk është kryer nga persona fizik ose juridik te paisur me licensen përkatës, nuk është lidhur kontratë dypalëshe ku të përcaktoheshin detyrimet e ndërsjellta kushtet e punës dhe shpërblimi , sipërmarrësi nuk ka njoftuar me shkrim per perfundimin e punimeve shoqeruar me dokumentat përkatës. Për marrjen në dorëzim të punimeve nuk është hartuar procesverbali i kolaudimit i cili firmoset nga kolaudatori ose grupi i kolaudimit ,sipërmarrësi dhe mbikeqyrësi i punimeve.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.Gjetje .Bazuar në dokumentat standarte të tenderit për punë publike ,autoriteti kontraktor duhej të kishte perfshire si pjesë integrale të kontratës rrugët në të cilat do te ndërhyhet me preventivë analitikë si dhe afat të kryerjes së punimeve.Autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër është mjaftuar me një preventiv të përgjithshëm ,pa përcaktuar objektet ku do te ndërhyhet si dhe pa përcaktuar afatet për kryerjen e punimeve në objekte.

2.Gjetje.Autoriteti kontraktor duhet të kishte bashkelidhur kontratës themelore në aneksin kushte te veçanta të kontrates specifikimet teknike të kryerjes së punimeve ,nga auditimi i kryer ka rezultuar se në kushtet e veçanta nuk janë përcaktuar specifikimet teknike.

3.Gjetja .Në referencë të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave 10/1 datë 28.02.2017 për përgatitjen e buxhetit vendor Kreu IV Drejtoria e Shërbimeve Publike bazuar në kontratën themelore dhe oferten e fitimit të tenderit për mirëmbajtjen e rrugëve ,duhej të kishte paraqitur preventivet analitike të kryerjes së mirembajtjes për rruge dhe trotuare sipas vendndodhjes dhe shoqëruar me planimetri dhe preventiv ndërhyrje ose në mungesë të pakten ne fillim te vitit buxhetor duhej te ishte bërë kërkesë pranë autoritetit kontraktor për miratimin e shpenzimeve në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve sipas vendndodhjes së tyre.Nga auditimi i kryer rezultoi se Drejtoria e Shërbimeve Publike ka paraqitur kërkesë për shpenzime për mirëmbajtje rruge dhe trotuare në total pa bërë analizë të shpenzimeve sipas vendndodhjes së rrugës dhe trotuareve si dhe pa planimetri te ndërhyrjes,gjithashtu nuk është bërë miratim nga autoriteti kontraktor në fillim të vitit buxhetor (perjashtohet viti 2018, pasi jane specifikuar rrugët, jane hartuar preventivet si dhe janë perpiluar planimetrite e ndërhyrjes)..I vetmi dokument qe vërteton ndërhyrjen e rrugëve është librezja e masave i miratuar nga autoriteti kontraktor dhe supervizori. Nuk është ushtruar kontrolli i brendshëm,duke vepruar në kundërshtim me nenin 11 ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

4.Gjetja.Në reference te pikës 1 nenit 60 te ligjit nr.9643 Date 20.11.2006 i ndryshuar ,”Për prokurimin Publik” kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese,por nga auditimi rezultoi se preventivi fitues për vitin 2017 janë shtuar punime me vlere 1.241.215 lek si dhe jane zbritur punime me vlere 1.066.082 lek,ndërsa për vitin 2018 janë shtuar punime me vlerë 540.199 lek si dhe janë zbritur punime me vlerë 364.152 lek,keto veprime bien në kundërshtim me pikën 1 nenit 60 te ligjit nr.9643 Date 20.11.2006 i ndryshuar ,”Për prokurimin Publik”.

5.Gjetje Në referencë te pikës 2 udhëzimit nr 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar,mbikëqyrja e punimeve kryhet nga persona fizik ose juridik te paisur me license përkatëse,qe do të thotë punonjës jasht strukturave të Bashkise Shkodër.Nga auditimi i kryer ka rezultuar se për periudhen prill 2016 është ndjekur nga ish inxhinierja e Shërbimeve Publike kurse Prill 2016 eshte ndjekur nga inxhinierja e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.Ky veprim bie në kundërshtim me piken 2 udhëzimit nr 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndërtimit” i ndryshuar.

6.Gjetje. Në referencë të pikës 3 udhezimi nr 3 date 15.02.2001” Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar,duhej të ishin përcaktuar detyrimet e ndërsjellta kushtet e punës dhe shpërblimi.Nga auditimi i kryer ka rezultuar se nuk është lidhur kontratë dypalëshe ku të përcaktoheshin detyrimet e ndërsjellta kushtet e punës dhe shpërblimi.Ky veprim bie në kundërshtim me piken 3 udhezimi nr 3 date 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndërtimit” i ndryshuar.

7.Gjetje.Në referencë te pikës 15 udhezimi nr 3 datë 15.02.2001” Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndërtimit” i ndryshuar,sipermarrësi duhej të kishte njoftuar me shkrim përfundimin e punimeve shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar.Nga auditimi i kryer rezultoi se sipermarresi nuk ka njoftuar me shkrim dhe nuk ka paraqitur dokumentat sipas kërkesave te pikes 15.Ky veprim bie ne kundërshtim me piken 15 udhëzimi nr 3 datë 15.02.2001” Per mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndërtimit” i ndryshuar.

8.Gjetje.Në referencë të pikëve 6-14 supervizori duhej të kishte bërë mbikëqyrjen e punimeve .Nga auditimi i kryer dokumentacionit teknik dhe ligjor rezultoi se mbikëqyresi i punimeve ka hartuar preventivat vjetore dhe më pas janë miratuar nga autoriteti kontraktor,ka mbikëqyrur punimet si dhe ka marrë në dorëzim punen e kryer,duke krijuar konflikt të hapur ineteresi me punen e ngarkuar si dhe ka vepruar në kundërshtim me Kreun II të udhëzimit nr.3 duke marrë përsipër kompetencat e kolaudatorit.

9.Gjetje.Në referencë të Kreut II pika 7 në përfundim të kryerjes së punimeve hartohet procesverbali i kolaudimit i cili firmoset nga kolaudatori ose grupi i kolaudimit ,sipermarrësi dhe mbikëqyresi i punimeve.Nga auditimi i kryer rezultoi se në marrjen në dorezim është mjaftuar nga procesverbal i cili eshte firmosur nga sipermarrësi,mbikëqyrësi i punimive, dhe nga autoriteti kontraktor duke vepruar ne kundërshtim me Kreut II pika 7 te udhëzimit Nr.3 Datë 15.02.2001 “Per Mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit”.

4.Rekomandime

a. Bazuar në argumentimet e trajtuar ne këtë raport rekomandojme me përfundimin e kontrates te mos vazhdojë më tejë kjo lloj procedure.

b. Sektori i Planifikimit e Mirëmbajtjes së Infrastruktures,të fillojë menjehere punen në terren,të evidentojë dëmtimet emergjente në rruge dhe trotuare,të hartojë projektin duke bashkëlidhur planimetritë dhe preventivat dhe ti paraqesë për miratim si dhe të bëhet e mundur që në vitin 2019 te planifikohen në buxhet dhe të prokurohen sipas kerkesave te ligjit “Për prokurimin publik”

c. Për periudhat 2020 e në vazhdim , Sektori i Planifikimit e Mirëmbajtjes së Infrastruktures,në periudhen Janar-Maj të bëjë studimin e rugeve dhe trotuareve për ndërhyrjet e mundshme të hartojë projektin dhe brenda muajit Maj të paraqesë pranë Grupit të Menaxhimit Strategjik për përfshirjen në buxhetin e vitit 2020 duke përfshirë:projekt,preventiv,specifikime teknike.

d. Mbikeqyerja e punimeve të bëhet me persona fizik ose juridik pajisur me licensë përkatëse si dhe të mos jetë i punësuar në Bashkinë Shkodër.

e. Sektori i Planifikimit e Mirëmbajtjes së Infrastruktures,të hartojë dhe të miratojë planin e veprimit për kontrolle në terren si dhe të informojë me shkrim Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike si dhe ky i fundit Kryetarin e Bashkise lidhur me mbarëvajtjen e punës për rrugët dhe trotuaret.

Njësia Auditimit Brendshëm

Bashkia SHKODËR